



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF  
KOSOVO  
Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik



01-*106/02-12859/20*  
22.06.2020

## R A P O R T

### I PUNËS SË SHTABIT KOMUNAL PËR PARANDALIMIN E COVID-19 PËR KUVENDIN KOMUNAL NË KAÇANIK

KAÇANIK  
2020

## Hyrje:

Komuna e Kaçanikut duke përejellur me një përkushtim tejet të madh rrëthanat aktuale nëpër të cilat ishte duke kalur shteti ynë dhe jo vetëm, si pasojë e situatës së krijuar nga virusi i ri i cili kishte kapluar botën, duke parë rrezikun e përhapjes së këtij virusi me një shpejtësi të madhe e sidomos pas rasteve të para të paraqitura në shtetin tonë, duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L 040, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, nen 13 si dhe në Statutin e Komunës së Kaçanikut nen 79, me vendimin nr. 01 104/02-8765 të datës 11.03.2020 ka formuar Shtabin Komunal për parandalimin e COVID-19. Shtabi Komunal u formua për të menaxhuar me situatën e krijuar nga koronavirusi si dhe për të ndihmuar në parandalimin e këtij virusi.

## Përbërja e Shtabit Komunal për parandalimin e COVID-19:

Anëtarët e Shtabit Komunal janë emëruar nga institucione dhe subjekte të ndryshme të komunës tonë, kshti duke angazhuar të gjithë ata të cilët në mënyrë direkte do ti kontribuonin parandalimit të këtij virusi dhe menaxhimit më të situatës së krijuar.

Shtabi Komunal përbëhet nga 15 anëtar si në vijim:

- 1.Besim Ilazi, Kryesues i Shtabit
- 2.Diana Bajrami Reka- Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
3. Bahri Selimi, Drejtore i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
4. Ramadush Osmani Drejtore i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
5. Fidaim Fazliu, Kryetar i Bashkësisë Islame në Kaçanik
- 6.Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit Komunal në Kaçanik
- 7.Agim Mani, Asambleist nga LVV
- 8.Kadri Krivanjeva, Asambleist nga PDK
- 9.Besnik Salihu, Asambleist nga LDK
- 10.Sinan Zeneli, Drejtore i QKMF- në Kaçanik
- 11.Naim Hysa, përgjegjës i Kryqit të Kuq në Kaçanik
- 12.Halim Shehu, Komandant i Stacionit Policor
13. Ylber Tusha, përsaqësues i Bizneseve
14. Bujar Bajra Zyrtar për Alarmit dhe Koordinimin Emergjent
- 15.Besnik Bajra, Inspektor Sanitar

## Mbledhjet e Shtabit Komunal:

Që nga formimi i shtabit e deri më tani janë mbajtur gjithësej 12 takime të shtabit komunal, 11 prej tyre janë të mbajtura me procesverbal, ndërsa takimi i parë nuk është mbajtur me procesverbal, për arsyte teknike.

Në të gjitha takimet e mbajtura prezencia e anëtarëve të shtabit komunal ishte mjastë e kënaqshme.

Po ashtu në njërin prej takimeve prezert ishte edhe Profesor Lul Raka i cili ndau me anëtarët e shtabit informacione lidhur me parandal min e virusit korona.


Në shumë prej takimeve prezant kishim edhe Drejtoren Rajonal të Policisë z. Emin Beqiri si dhe Doktoreshën Sevdije Mehmeti nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë.

Përveç takimeve shtabi ka pasur vazhdimisht kontakte edhe nëpërmjet grupit viber.

Më datë 17.03.2020 Kryesuesi i Shtabit takoi shefat e grupeve parlamentare të Kuvendit Komunal në Kaçanik nga të cilët kërkoj mobilizim të plot për të ndihmuar në menaxhim të situatës së krijuar si pasojë e virusit COVID-19.

Ndërsa Kryesuesi i Shtabi-Kryetari i Komunës së bashku me disa anëtar të shtabit, më datë 28.03.2020 takoi administratorët e fshatrave dhe zonave urbane për të diskutuar rreth gjendjes aktuale nëpër vendbanimet e tyre, po ashtu për të krijuar edhe rrjetën e bashkëpunimit për të menaxhuar sa më mirë me situatën emergjente të krijuar në vend.





## **Vendimet e Shtabit Komunal:**

Që nga themelimi i shtabit janë marrë vendime të ndryshme si:

Në mbledhjen e datës 25.03.2020 Shtabi Komunal propozoi që Kuvendi Komunal të mbajë një mbledhje të jashtëzakonshme për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës emergjente të krijuar nga pandemia COVID-19.

Ndërsa Kuvendi Komunal në mbledhjen e jashtëzakonshme, të datës 26.03.2020, ndau 100.000.00 mijë euro për menaxhim me situatën e krijuar nga COVID-19.

Më datë 31.03.2020 pas ndarjes së mjeteve nga Kuvendi Komunal, nga anëtarët e shtabit u votua me shumicë të votave për ndarjen e 25.000.00 eurove për ti shpenzuar për furnizim dhe ushqim si dhe për të bërë dezinfektimin e objekteve publike dhe për subvencionimin e QKMF-së dhe Komunës së Kaçanikut me pasiже mbrojëse.

Ndërsa më datë 07.04.2020 anëtarët e shtabit me shumicë të votave votuan pro mbështetjes logjistike për administratorët e fshatrave dhe zonave urbane.

Shtabi Komunal duke analizuar çështjet se shumë familje ishin pa të ardhura mujore, shumë prej tyre raste sociale, më konkretisht mbi 800 familje, me datë 15.04.2020 vendosi që nga shuma e mjetëve të ndara nga Kuvendi Komunal të furnizoj me ushqim 1000 famije në nevojë.

Në mbledhjen e datës 26.04.2020, pas rastëve të para të paraqitura në komunën tonë, me konkretisht një rast në fshatin Rekë dhe një në fshatin Runjevë u vendos që familjarët e personave të rezultuar pozitiv të vetë izolohen dhe se në lagjet e tyre të vendosen patrolla të policisë.

Kurse më datë 22.05.2020 në mbledhjen e radhës të Shtabit Komunal, Kryetari i Komunës prezanton propozim-vendimin për Lirim nga qiraja për pronën komunale për vitin 2020 dhe përlirim nga pagesa për shërbime shëndetësore deri në përfundim të pandemisë, vendim i cili u votua në mbledhjen e radhes së Kuvendit Komunal.

## **Rekomandimet e Shtabit Komunal:**

Anëtarët e Shtabit Komunal në çdo takim ishin tejet bashkëpunues kështu duke dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm të angazhimit të tyre.

Secili prej tyre kishte ide dhe rekomandime të arsyeshme, me posht do ti paraqesim disa prej tyre, rekomandime të cilat ishin po ashtu të përektuara edhe nga Ministria e Shëndetësisë:

- Të respektohet distanca sociale;
- Të kenë kujdesë qytetarët gjatë ceremonive mortore;
- Patrolla më të shumta nga ana e policisë për qytetarët që frekunetojnë nga komunat tjera sidomos nga komunat vatra;
- Të bëhet dezinfektimi i objekteve dhe hapësirave publike;
- Të kërkohet dezinfektimi i Dyqaneve dhe Barnatorëve nga ana e vet pronarëve;

- U kërkua nga qytetarëve të cilët vijnë për shërbime në të gjitha Institucionet Publike të vendosin maska dhe doreza;
- Të ketë patrolla nga ana e policisë nëpër fshatra dhe zona urbane;
- Të ketë kontrolla nga Inspektorati edhe nëpër dyqane nëpër fshatra dhe zona urbane;
- Të anulohen të gjitha aktivitetet komunale festive;
- Të ndalohen tubimet e ndryshme nga ana e qytetarëve etj.



### Kërkesat e Shtabit Komunal:

Pas marrjes së vendimit Nr. 01/09 të datës 13.03.2020, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Kryetari i Komunës së Kaçanikut më datë 16.03.2020 ka parashtruar kërkesë në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, Ministrit të Shëndetësisë si dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Ambientit, për tu dalur në ndihmë familjëve në nevojë në Komunën e Kaçanikut si dhe ka kërkuar paisjen me doreza, maska dhe injete dezinfektuese nga institucionet përkatëse.

Po ashtu më datë 27.04.2020 Kryesuesi i Shtabit Komunal-Kryetari i Komunës ka parashtruar përsëri kërkesë në Ministrinë e Shëndetësisë por si në kërkesën e parë ashtu edhe në të dytën nuk kemi marr përgjigje nga institucionet e lartëcekura.

Ndihmesat nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë kanë qenë tejet minimale vetëm me disa paisje imbrojtëse.

Në po të njëjtën datë është parashtruar kërkesë për ndihmë në Shoqatën Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", shoqatë nga e cila është konfirmuar menjëherë gatishmëria për të na ndihmuar.

#### **Ndihmat e pranuara në Shtabin Komunal për qytetarët e Komunës së Kaçanikut:**

Që nga fillimi i pandemisë Komuna e Kaçanikut ishte me fat që kishte përkrahjen e shumë miqve dhe njerzve të vullnetit të mirë.

Edhe në këso ditë nuk mungoi kontributi i shoqatave dhe qytetarëve tanë për t'ua lehtesar gjendjen familjeve në nevojë.

Duke pas parasysh që ishte një numër i madh i ndihmave të cilat vinin nga njerëz dhe organizata të ndryshme, Shtabi Komunal vendosi cë të gjitha ndihmat e pranuar të shpërndahen nga ekipa e Kryqit të Kuq, ndërsa familjet në të cilat duhet të dërgohen në ndihmat u vendos që të identifikohen nga administratorët e fshatrave dhe lagjeve urbane, në mënyrë që të këtë gjithëpërfshirje të familjeve në të gjitha vendet e komunë sonë.

#### **Në vijim do të paraqitet tabela e donatorëve:**

<b>Donatori</b>	<b>Sasia</b>	<b>Familjet përfituese</b>	<b>Shpërndaria</b>
Kryqi i Kuq-Kaçanik	150 pako ushqimore dhe 150 thas miell 25 kg.	150 familje	Nga Kryqi i Kuq
ETC	200 thas miell 25.kg, 2 litra lëngje dhe 2 litra qumshtë	200 familje	Nga Kryqi i Kuq
Fondacioni Labi	300 pako ushqimore	300 familje	Nga Kryqi i Kuq
Kryqi i Kuq-Kaçanik	325 pako higjenike	325 familje	Nga Kryqi i Kuq
Komuna e Kaçanikut	1000 pako ushqimore dhe 1000 kg., thas 25 kg.	1000 familje	Nga Kryqi i Kuq
Bashkësia Islame në Kaçanik	200 thas miell nga 25 kg	200 familje	Nga Kryqi i Kuq
Shoqata Bereqeti	50 pako ushqimore	50 familje	Nga Kryqi i Kuq
Halil Gashi-mërgimtar	50 pako ushqimore	50 familje	Nga Kryqi i Kuq
Mulliri "Guri" Drenas	5000 kg. Miell	100 familje	Nga Kryqi i Kuq

"Jetimat e Ballkanit"	100 pako ushqimore, 100 thas miell nga 25 kg si dhe 100 pako higjenike	100 familje	Nga Kryqi i Kuq
Viva Fresh	150 pako ushqimore	150 familje	Nga Kryqi i Kuq
JN-UNMIK	50 pako ushqimore dhe 40 pako higjenike	50 familje	Nga Kryqi i Kuq
Kryqi i Kuq	65 pako higjenike, 65 pako ushqimore dhe 65 thas miell nga 25 kg.	65 familje	Nga Kryqi i Kuq
Komuna e Kaçanikut	600 pako ushqimore dhe 600 thas miell nga 25 kg.	600 familje	Nga Kryqi i Kuq
Bone Vet	Maska	Për stafin shëndetësor dhe punëtorët e administratës Komunale	Nga Bone Vet

#### Gjithsej në total janë shpërndar:

- 2.465 pako ushqimore
- Mbi 1.315 thas miell si dhe
- 350 pako higjenike

Ndërsa në total kanë pranuar këto ndihma rrëth 3.340 familje, më konkretisht shumë nga familjet kanë pranuar ndihma edhe për të dytën herë.

Po ashtu ka pasur edhe ndihma të tjera nga mërgata dhe indivitë të tjerë por të cilat janë shpërndar individualisht nga vet ata.





Raporti Financiar i shumës së mjeteve të ndara me vendim Nr. 01-400/01-8928/20 i datës 26.03.2020 nga Kuvendi Komunal i Komunës së Kaçanikut:

Meqenëse pika e dytë e këtij vendimi ka paraparë që shuma e mjeteve buxhetore të lejuara të shfrytëzohet për sigurimin e artikujve (pakove) ushqimore, higjenike për familjet në nevojë, dezinfektimin e objekteve dhe hapësirave publike, furnizimin me mjetë mbrojtëse nga COVID-19 dhe mbulimin e nevojave tjera që dalin si rezultat i parandalimit të kësaj pandemie, ashtu edhe është vepruar nga ana e Shtabit Komunal në menaxhimin e këtyre mjeteve.

Nga tabela e donatorëve shohim qartë që Komuna e Kaçanikut ka ndarë një numër të madh të pakove ushqimore, higjenike dhe miellit për familjet në nevojë.

Po ashtu është bërë dezinfektimi i objekteve dhe hapësirave publike në Komunën e Kaçanikut.

Duke pas parasysh që QKMF-Kaçanik ka pasur një ndihmes tejet minimale nga Ministria e Shëndetësisë, Shabi Komunal ka qenë i detyruar të ndihmojë këtë institucion me një shumë të mjetëve për tu furnizuar më paisje mbrojtëse.

Po ashtu siç edhe është përmendur më lartë, administratorët e fshatrave janë ndihmuar secili me derivate në vlerë prej 50.00 eurove.

Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosovo		Komuna e Kaçanikut Opština Kacanik Municipal Kacanik	
Shpenzimet për Covid -19 për Komune e Kaçanikut			
Bloku kodues	Përskrim	Në proces për shpenzim	Shpenzimet
<b>652 - KAÇANIK</b>		<b>12,383.71</b>	<b>72,179.00</b>
00099 - PËR MENAXHIMIN E EMERJENÇES NGA COVID-19			
SHERBIME KONTRAKTUESE TJERA		10,289.00	2,904.00
FURNIZIME MJEKESORE		500.00	12,061.00
FURNIZIME PASTRIMI		980.00	0.00
FURNIZIME ME USHQIM DHE PJE		159.71	57,214.00
PAISJE TJERA		455.00	0.00

Drejtori I DFEZH-së  
Bahri Selimi

#### Statistikat e personave të prekur me virusin COVID-19 në Komunën e Kaçanikut:

Jemi ndër komunat e pakëta të Republikës së Kosovës që kemi pasur një numër të vogël të të prekurve me virus.

Ndonëse për Komunën e Klinës dhe Malishëves rastet e para ishin paraqitur qysh në fillim të muajit mars në komunën tonë rastet e para u paraqiten më datë 26.04.2020.

Dy rastet e para ishin një në fshatin Runjevë dhe një në fshatin Rekë.

Më pastaj si pasojë e kontaktit me personin e rezultuar pozitiv nga fshati Runjevë kishim edhe 5 persona tjerë të cilët po ashtu rezultuan pozitiv.

Pas vetë izolimit të tyre fatmirësisht të gjithë personat u shëruan ndërsa për një kohë të gjatë nuk kishim rastë të tjera.

Pastaj në muajin qershor një person tjetër nga Komuna e Kaçanikut rezultoi pozitive dhe e njëjtë aktualisht është në vet izolim së bashku me familjarët e saj, ndërsa më datë 21.06.2020 edhe një fëmijë rezultoi pozitivë

Pra deri më tanë kemi dy raste aktive me virusin COVID-19.

#### Përfundim:

Në këtë raport të Shtabit Komunal për Parandalimin e virusit COVID-19 janë përfshirë të gjitha aktivitetet, mbledhjet, vendimet, rekomandimet, kërkesat, ndihmat e pranuara si dhe raporti financaiar.

Që nga data 13.03.2020, që kur edhe është themeluar ky Shtab vazhdimi i ka pasur angazhim maksimal nga të gjithë anëtarët e shtabit për të menaxhuar me situatën e krijuar nga COVID-19.

Për faktin se akoma ka rritje të numrit të vazhdueshëm të personave të infekuar me këtë virus dhe se duke mos e ditur se si do të shkojë më tejë rrjedha e kësaj pandemie, Shtabi Komunal vazhdonë të funksionoj edhe më tejë dhe do të jetë aktiv deri në një vendim tjetër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

#### Këtij rapporti i bashkangjiten:

- ✓ Vendimi për Formimin e shtabit Komunal dhe Plotësim-Vendimi për formimin e Shtabit Komunal;
- ✓ Prosesverbalet e mbledhjeve të Shtabit Komunal;
- ✓ Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin me situatën e krijuar nga COVID-19;
- ✓ Kërkesa e Shtabit Komunal drejtar Zyres së Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- ✓ Kërkesa e Shtabit Komunal drejtar Ministrisë së Shëndetësisë;
- ✓ Kërkesa e Shtabit Komunal drejtar Shoqatës "Jetimat e Ballkanit";
- ✓ Vendimi për Lirim nga qiraja për pronën komunale për vitin 2020 dhe për lirim nga pagesa për shërbime shëndetësore deri në përfundim të pandemisë.
- ✓ Raporti i shpenzimeve për COVID-19 për Komunën e Kaçanikut

Kryetari i Komunës së Kaçanikut-Kryesuesi i Shtabit Komunal

Z. Besim Hazi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës  
Skupština Opština  
Municipal Assembly

Data	13.03.20	Vend	KAÇANIK
Organ	Numeri	Bloqe	
01	101/02-S/65	/.	

Bazuar në nenin 13 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 79 pika, f dhe h të statutit të Komunës 01 Nr3588/2008 datë 25.09.2008, si dhe zbatimit të vendimit të qeveris së Kosovës, nr 01/07 I dates 11.03.2020, l dhur me situaten e krijuar nga rreziku i përhapjes së korona virusit në Republikën e Kosovës dhe me qëllim të ndërmarrjës së masave preventive në Komunën e Kaçanikut , Kryetari I Komunës , merr këtë:

#### VENDIM


#### PËR FORMIMIN E SHTABIT PËR PARANDALIMIN E COVID-19 NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

1. Formohet shtabi Komunal për koordinim të aktiviteteve preventive për parandalim të COVID-19 Në Komunën e Kaçanikut në këtë përbërje:

- 1.1 Diana Reka, Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenje sociale – kryesuese e shtabit
- 1.2 Zahir Doda, drejtor për Arsim dhe kulturë – anëtarë.
- 1.3 Ramadush Osmani, drejtor për Shërbime Publike – anëtarë.
- 1.4 Sinan Zeneli drejtor i QKMF-së – anëtarë.
- 1.5 Besnik Bajra – Inspektor Sanitar – anëtarë.
- 1.6 Halim Shehu – Komandat i stacionit policor në Kaçanik – anëtarë.
- 1.7 Ylber Tusha – përfaqësues i bizneseve të komunnës Kaçanikut – anëtarë.
- 1.8 Fidaim Fazliu – Kryetar i këshillit të Bashkësisë Islame në Kaçanik
- 1.9 Bujar Bajra zyrtar për emergjencë

**Z** Detyrë e shtabit komunalë është që secili në kuadër të kompentecave dhe përgjegjësive ligjore të ndërmerr masat e nevojshme për parandalimin e ç'faqjes, përkatësish përhapjes së Korona virusit në Komunën e Kaçanikut . Duke e ditur se epidemiologja e Korona virusit tani më është shfaqur në të gjitha vendet fqinje , për shkak të rezikut të përhapjes së saj edhe te ne, është më se e domosdoshme që të përcillen në qdo kohë kërkesat dhe rekomandimet e Qeverisë së Kosovës dhe instucioneve më të larta shëndetësore me qëllim që të jemi në nivel të detyrës.

3. Shtabi komunal duhet të jetë i angazhuar 24 orë dhe të veproj në bazë të rrrethanave dhe situatës së krijuar në teren .
4. Për qdo veprim të ndërmarrë duhet njoftuar organet kompetente sipas ligjit në fuqi .
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit .



Z.Besim Ilazi  
  
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

16.03.2020 VENIKA KAÇANIK  
Numri: 01-10002-830/20



Kuvendi i Komunës  
Skupština Opština  
Municipal Assembly

Bazuar në nenin 13 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L.-040, nen 79 pika, f dhe h të statutit të Komunës 01 Nr3588/2008 datë 25.09.2008, si dhe zbatimit të vendimit të qeveris së Kosovës, nr 01/07 I dates 11.03.2020, l dhur me situaten e krijuar nga rreziku i përhapjes së korona virusit në Republikën e Kosovës dhe me qëllim të ndërmarrjës së masave preventive në Komunën e Kaçanikut , Kryetari i Komunës , merr këtë:

#### PLOTESIM NDRYSHIM VENDIMI

#### PËR FORMIMIN E SHTABIT PËR PARANDALIMIN E COVID-19 NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

1. Formohet shtabi Komunal për koordinim të aktiviteteve preventive për parandalim të COVID 19 Në Komunën e Kaçanikut në këtë përberje:

- 1.1 Besim Ilazi, Kryetar i Komunes, kryesues i shtabit
- 1.2 Diana Reka, drejtoreshë për shëndetësi dhe mirëqenje sociale –zv. Kr. e shtabit
- 1.3 Kemajl Merseli, Kryesues i Kuvendit – anëtarë.
- 1.4 Ramadush Osmani, drejtor per Shërbime Publike – anëtarë.
- 1.5 Sinan Zeneli drejtor i QKMF-së – anëtarë.
- 1.6 Besnik Bajra – Inspektor Sanitar – anëtarë.
- 1.7 Halim Shehu – Komandat i stacionit policor në Kaçanik – anëtarë.
- 1.8 Ylber Tusha – përfaqësues i bizneseve të komunnës Kaçanikut – anëtarë.
- 1.9 Fidaim Fazliu – Kryetar i këshillit të Bashkësisë Islame në Kaçanik
- 1.10 Naim Hysa, Kryqi i Kuc
- 1.11 Bujar Bajra zyrtar për emergjencë
- 1.12 Kadri Krivanjeva, anetar i kuvendit

## **Procesverbal i mbledhjes së Shtabit Komunal për Parandalimin e COVID 19, i datës 25.03.2020**

### **Të pranishëm:**

1.Diana Bajrami Reka- Kryesuese e Shtabit- Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

2.Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

3.Bujar Bajra Zyrtar për Alarmit dhe Koordinimin Emergjent

4.Halim Shehu, Komandant i Stacionit Policor në Kaçanik

5.Fidaim Fazliu, Kryetar i Bashkësisë Islame në Kaçanik

6. Ramadush Osmani Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës

7. Bahri Selimi, Drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit

8.Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit Komunal në Kaçanik

9. Besnik Bajra, Inspektor Sanitar

10.Sinan Zeneli, Drejtor i QKMF- në Kaçanik

11.Naim Hysa, përgjegjës i Kryqit të Kuq në Kaçanik

12.Zahir Doda, Drejtor i Arsimit dhe Kulturës në Kaçanik

### **REND DITE**

- 1. Diskutim rreth gjendjes aktuale lidhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut;**
- 2. Propozim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situateve emergjente të krijuar nga pandemia COVID-19;**
- 3. Të ndryshme.**

#### **1.Diskutim rreth gjendjes aktuale lidhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut**

Kryetari i komunës hapi takimin duke i përvendosur anëtarët e Shtabit Komunal dhe njëkohësisht i falenderoj për bashkëpunim dhe angazhimin e tyre gjatë gjithë kësaj periudhe.

Ai po ashtu e njoftoj shtabin me të gjitha vendimet e deri tashme të Qeverisë së Republikës së Kosovës duke treguar se ato vendime janë duke u respektuar nga institucionet komunale dhe qytetarët.

**Kryetari i Bashkësisë Islame në Kaçanik, z.Fidaim Fazliu:** njofti shtabin se nga 17 Xhamit të cilat janë në Komunën tonë vetëm në 8 prej tyre është duke u thirrur Ezani. Në të gjitha Xhamit po ashtu është ndalur dhe falja kështu duke parandaluar përhapjen e COVID 19.

Kryetari informoi se si Bashkësi Islame kanë shpërnda 150 pako ushqimore në vlerë prej 30 euro për familjet në nevojë. Sa i përketë situates aktuale qytetarët janë të vetëdijesuar dhe janë duke i respektuar masat e vendosura nga qeveria.

**Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq në Kaçanik z. Naim Hysa:** theksoi se çdo ditë Kryqi i Kuq është i gatshëm të ndihmoj për çdo gjë rreth situates së kësaj pandemie. Ai kërkoi leje qarkullimi nga Policia e Kosovës. Gjithashtu kërkoi që të bëhet një koordinim me Shtabin Komunal sa i përket distribuimit të ndihmave për familjet në nevojë kështu që të mos i dërgojmë ndihma një familje dyherë, ndërsa familjeve tjera asnjëherë.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal z.Kemal Murseli:** propozoi që të krijohet një depo për dërgimin e të gjitha ndihmave që vijnë nga qytetar dhe biznese të ndryshme, me këtë mund ta dijm më lehtë se kush nga familjet në nevojë po merr ndihma dhe kush jo dhe ta dijm se si po shpërndahen ato.

Ai njoftoi se miell po hyn vazhdimisht në Kosovë por me të po furnizohen vetëm ata që kanë të holla për ta blerë. Ai kërkoi të krijohet një fond, të ndërmarrim hapa paraprak dhe kur të paraqitet nevoja të reagojmë me kohë.

Kuvendi ka shpreh gatishmërinë për një gjë të tillë. Kryesuesi ka kërkuar po ashtu që fillimisht të mbrojmë stafin mjekësor dhe policinë e pastaj të vazhdojmë më tejë.

**Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale, znj. Diana Bajrami Reka:** deklaroi se ETC ka shpreh gatishmërinë për ti ndihmuar 200 familje në nevojë por se ndihmat dëshiron ti shpërndaj nëpërmjet komunës.

**Drejtori i Shërbimëve Publike dhe Emergjente, z. Ramadush Osmani:** njoftoj se kompania e Ujësjellësit dhe ajo e Pastërtisë janë duke punuar në orare të caktuara dhe shërbimet janë duke u kryer me kohë.

Ka një shqetësim për 4 punëtorët e Stacionit të Autobusëve në Kaçanik të cilët nuk mund të marrin pagë për shkak se të ardhurat e tyre varen nga funksionimi i Stacionit të Autobusëve dhe siç e dijm qeveria ka marr vendim për ndalimin e qarkullimit të transportit urban. Shpresojmë që nga niveli qëndror të mirret ndonjë vendim në favor të tyre.

**Inspektori Sanitar, z.Besnik Bajra:** Njoftoj shtabin se janë duke u respektuar vendimet e qeverisë nga operatorët ekonomik dhe se ai është në kontakt të vazhdueshëm me policinë dhe se vazhdimisht është në teren.

**2.Në pikën e dytë të rendit të ditës anëtarët e Shtabit Komunal për parandalimin e COVID 19 propozuan dhe kërkuan nga ekzekutivi komunal që të përgatisin popozim-vendim për Kuvendin Komunal në Kaçanik**

## **Procesverbal i mbledhjes së Shtabit Komunal për Parandalimin e COVID 19, i datës 31.03.2020**

### **Të pranishëm:**

- 1.Besim Ilazi, Kryetar i Komunës, Kryesues i Shtabit
- 2.Diana Bajrami Reka- - Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- 3.Bujar Bajra Zyrtar për Alarmit dhe Koordinimin Emergjent
- 4.Halim Shehu, Komandant i Stacionit Policor në Kaçanik
- 5.Fidaim Fazliu, Kryetar i Bashkësisë Islame në Kaçanik
6. Ramadush Osmani Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
7. Bahri Selimi, Drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
- 8.Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit Komunal në Kaçanik
- 9.Agim Mani, Asambleist
- 10.Sinan Zeneli, Drejtor i QKMF- në Kaçanik
- 11.Naim Hysa, përgjegjës i Kryqit të Kuq në Kaçanik
- 12.Kadri Krivanjeva, Asambleist
- 13.Besnik Salihu, Asambleist

### **REND DITE**

1. Diskutim rreth gjendjes aktuale lidhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut;
2. Të ndryshme

#### **1.Diskutim rreth gjendjes aktuale lidhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut**

Kryetari i komunës z.Besim Ilazi u dëshiroi mirë se ardhje anëtarëve të shtabit, duke i falenderuar për angazhimin e tyre në këto ditë. Kryetari deklaroi se edhe në këtë takim fatmirësish në komunën tonë nuk kemi asnjë person të prekur me virus.

Por shprehim keqardhje për të gjithë personat e prekur. Njëkohësisht më lejoni të falenderoj të gjithë ata që na ndihuan këto ditë me ndihma, si ndihma simbolike e ETC me miell qumshët dhe lëngje, por po ashtu edhe nga Viva e cila ndihmojë 150 familje si dhe nga fondacioni i Labinot Tahirit për 300 familje.

**Asambleisti Kadri Krivanjeva** gjatë takimit ngriti një çështje preukupuese për të, faktin se gjatë kësaj kohe ka shumë qytetar që nuk janë duke punuar për shkak të pandemise. Si punëtor të sektorit privat nuk kanë të ardhura dhe tani kanë nevojë përkrahje.

Duhet ta kemi parasysh edhe këtë kategori.

**Kryetari i Komunës** deklaroi se pajtohet me këtë çështje dhe këtë propozim sepse edhe për të është mjaftë shqetësuese.

**Raporti i Drejtorit të QKMF- Kaçanik, z. Sinan Zeneli:** Situata me COVID-19 në komunën tonë është e menaxhueshme për momentin, të shtunen kemi pas një person që ka bërë analizën por fatmirësisht ka rezultu negativisht.

Drejtori njoftoj se kanë pas disa maska të dhuruara nga disa qytetar dhe nga Labinot Tahiri të cilët i falenderon shumë.

Janë caktuar oraret e punës së Barnatorëve dhe po ashtu të stafit mbështetës në pikën kufijtare.

**Kryetari i Bashkësisë Islame në Kaçanik, z. Fidaim Fazliu:** Përvendetje për të gjithë, sa i përketë Bashkësisë Islame ne jemi duke punuar me staf të reduktuar, gjendja është në kontroll dhe po me vjen mirë që tek qytetarët ka një vedijësim të tillë kaq shpejt. Nuk kam diçka të veçantë të shtoj për momentin.

**Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq në Kaçanik z. Naim Hysa:** Njoftoji shabin se diku 650 pako kemi pranuar dhe se shpërndarja e tyre është bërë shumë shpejt.

I falenderoj të gjithë administratorët për bashkëpunimin e dhe angazhimin e tyre, diku 633 familje deri më tani kanë përfituar.

**Drejtori i Shërbimëve Publike dhe Emergjente, z. Ramadush Osmani:** Propozi që sot përveç pikës së parë të Furnizimit me pako ushqimore të votohet Dezinfektimi i objekteve publike dhe Subvencionimi I QKMF me mjete mbrojtëse.

**2.Të ndryshme:-** Në këtë pikë të gjithë anëtarët e shtabit me shumicë të votave votuan pro shumës 25.000.00 euro për ti shpenzuar për nevojat furnizim me ushqim.

Po ashtu me shumicë votash votuan pro lejimit të Dezinfektimit të objekteve publike dhe Subvencionimit të QKMF me mjete mbrojtëse.

Procesmbajtësja: Ilirjana Berisha



## Procesverbal i mbledhjes së Shtabit Komunal për Parandalimin e COVID 19, i datës 07.04.2020

### Të pranishëm:

- 1.Besim Ilazi, Kryetar i Komunës, Kryesues i Shtabit
- 2.Diana Bajrami Reka- - Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- 3.Bujar Bajra Zyrtar për Alarmit dhe Koordinimin Emergjent
- 4.Fidaim Fazliu, Kryetar i Bashkësisë Islame në Kaçanik
5. Ramadush Osmani Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
6. Bahri Selimi, Drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
- 7.Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit Komunal në Kaçanik
- 8.Agim Mani, Asambleist
- 9.Sinan Zeneli, Drejtor i QKMF- në Kaçanik
- 10.Naim Hysa, përgjegjës i Kryqit të Kuq në Kaçanik
- 11.Kadri Krivanjeva, Asambleist
- 12.Besnik Salihu, Asambleist

### REND DITE

1. Diskutim rreth gjendjes aktuale lidhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut;
2. Të ndryshme

#### 1.Diskutim rreth gjendjes aktuale lidhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut

**Kryetari i komunës z.Besim Ilazi:** Falemnderit të gjithë anëtarëve të shtabit për pjesëmarrjen e sotme në këtë takim. Kryetari deklroi se edhe në këtë takim fatmirësish në komunën tonë nuk kemi asnjë person të prekur me virus deri më tanë.

Më lejoni të falenderoj të gjithë ata që na ndihmuan këto ditë me ndihma.

Ndihmat e pranuara dhe ato të ndara nga ne janë duke u shpërndar vazhdimisht nga Kryqi i Kuq të cilët edhe i falenderojmë për kontributin e tyre.

**Kryetari i Bashkësisë Islame në Kaçanik, z.Fidaim Fazliu:** Përvendetje për të gjithë, ne i kemi përcjell vazhdimisht shpëndarjen e ndihmave dhe jemi në kontakt të vazhdueshëm me administratorët e fshatrave.

Më duke se një pjesë e qytetarëve e kanë humb durimin dhe qytetarët nuk po i përfillin rregullat.

Ne duhet tē mirremi më shumë me Stacionin e Autobusëve sepse nëse ata nuk futen në pakon e Qeverisë ne duhet ti ndihmojmë atyre, besoj që tek Kompania e Ujësjellit dhe Kompania e Pastërtisë do tē ndihmohen nga Qeveria.

**Drejtora e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale, znj. Diana Bajrami Reka:**

Nuk kam cka tē shtojë nga ato që u thanë deri më tanë, por dua t'ju njoftoj se organizata "Human Appeal Internacional" ka kërkuar që ti ndihmojë fëmijët jetim në Komunën tonë. Dhe dje i kanë ndihmuar 120 fëmijë nga 60 familje.

**Asambleisti Agim Mani:** Kërkoi tē dijë nga Shtabi nëse kanë nevojë për vullnetarë tē ndihmojnë me shpërndarjen e pakove sepse po më duke se janë duke u shpërndarë ngadal pakot dhe se nuk janë duke u përfshirë tē gjitha familjet në nevojë.

**Kryetari i Shtabit:** Ndoshta mund tē ketë familje që nuk kanë marrë akoma pork jo varet nga administatoret e fshatrave apo lagjeve tē tyre sepse ne kemi kërkuar nga ta tē indentifikohen tē gjitha familjet, ndërsa **Naim Hysa** njoftoj edhe njëherë se mbi 1.000 familje kanë përsituar dhe jemi duke kërkuar vazhdimit nga administratorët që tē na ndihmojnë me identifikimin edhe tē familjëve tē nevojë që nuk marrin as ndihmë sociale.

**Asambleisti Kadri Krivanjeva:** Propozoj që mallin tē cilin do ta blejmë është mirë ta blejmë nga marketet tona vendore që t'ju ndihmojmë edhe atyre me tē hyra.

**Kryetari i Shtabit:** Nuk është e mundur kjo tani për shkak se veç se është e kontraktuar kompania por prap do ta shohim mundësinë me Prokurimin se çka mund tē bëjmë në këtë drejtim.

**2.Të ndryshme:-** Në këtë pikë tē gjithë anëtarët e shtabit me shumicë tē votave votuan pro ndarjes së mjetëve për:

1-Dezinfektimin e objekteve publike

2- Paisjen me mjete mbrojtëve si maska, doreza dhe mjete dezinfektuese për Komunë dhe QKMF

3-Mbështetje logistike për administratorët e fshatrave dhe lagjëve urbane.

**2.1 Rekomandimet e dalura nga ky takim:**

- Të respektohen distanca sociale;
- Të kenë kujdesë qytetarët gjatë ceremonive mortore;
- Patrolla më tē shumta nga ana e policisë për qytetarët që frekunetojnë nga Komunat tjera;
- Definfektimi i Dyqaneve dhe Barnatorëve nga ana e tyre;
- Kërkohet nga qytetarët tē cilët vijnë për shërbime në tē gjitha Institucionet Publike tē vendosin maska dhe doreza.
- Të ketë patrolla nga ana e policisë nëpër fshatra
- Të ketë kontrolla nga Inspektorati edhe nëpër dyqane nëpër fshatra

Procesmbajtësja: Ilirjana Berisha

## **Procesverbal i mbledhjes së Shtabit Komunal për Parandalimin e COVID 19, i datës 14.04.2020**

### **Të pranishëm:**

- 1.Besim Ilazi, Kryetar i Komunës, Kryesues i Shtabit
- 2.Diana Bajrami Reka- - Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- 3.Bujar Bajra Zyrtar për Alarmit dhe Koordinimin Emergjent
- 4.Fidaim Fazliu, Kryetar i Bashkësisë Islame në Kaçanik
5. Ramadush Osmani Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
6. Bahri Selimi, Drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
- 7.Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit Komunal në Kaçanik
- 8.Agim Mani, Asambleist
- 9.Sinan Zeneli, Drejtor i QKMF- në Kaçanik
- 10.Naim Hysa, përgjegjës i Kryqit të Kuq në Kaçanik
- 11.Kadri Krivanjeva, Asambleist
- 12.Besnik Salihu, Asambleist
- 13.Halim Shehu, Komandant i Stacionit Policor
14. Ylber Tusha, përfaqësues i biznesëve

### **REND DITE**

1. Diskutim rreth gjendjes aktuale lidhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut;
2. Të ndryshme

#### **1.Diskutim rreth gjendjes aktuale lidhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut**

##### **Kryetari i komunës z.Besim Ilazi:**

Të nderum ju falenderoj për pjesëmarrjen në këtë takim, tani ne jemi në një situatë krejt tjetër, me masa të reja të cilat do të hyjnë në fuqi nga dita e nesërme, të cilat përmua personalisht nuk janë të duhura, sidomos të delegohen këto kompetenca tek një ministër, ku qëndrimet e tijë nuk kanë qenë të tillë.

Në komunën tonë nuk kemi asnjë person të prekur me virus deri më tani.

Po ju infromoj se fondacioni BoneVet kanë dhuruar donacion me maska.

Nga ministrija ndihmesa është simbolke dhe ato mjete janë në përfundim. Kemi bërë një organizim ne kemi vendos edhe një tendë.

Propozojë që të reduktohet stafi i QKMF në mënyrë që të mos rrezikojmë të vet-izoohemi të gjithë.

**Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq në Kaçanik z. Naim Hysa:**

Me vendimin e ditës së djeshme kemi pas shumë thirrje, qytetarët janë të shqetësuar, gjendja nuk është e mirë.

Dua ta di përgjegjësinë e shtabit dhe të administratorëve sepse te premtën e kemi pas një keqkuptim dhe duhet të organizohemi më mirë.

Përfaqësuesi i biznesëve në Kaçanik, Ylber Tusha ka një shqetësim për pronarët e biznesëve të cilët nuk kanë të ardhura tjera.

**Asambleisti Kadri Krivanjeva:** Deklaroi se është i prekur nga rastet sociale dhe kërkonë bashkëpunim mes shtabit dhe kryqit të kuq sa i përketë bashkëpunimit.

**Kryetari i Bashkësisë Islame në Kaçanik, z.Fidaim Fazliu:** Këto 20 ditë nuk janë të pakta, kisha kërkuar nga komandanti që të ketë më shumë mirëkuptim, vendimet e marra janë vendime të marra për një shoqëri të avancuar dhe për ne janë të rënda.

Kërkojë të ketë mirëkuptim tek personat e sëmur, tek bujqit etj.


Nuk është e lehtë edhe për ne, pajtohem me Drejtoren Ramadush me atë çka tha, tek rasti i vorrimeve të paktën të kemi mirekuptim. Kemi raste kur na thirrin dhe na tregojnë se nuk kemi bukë, është pak e fryrë kjo nga ana e mediave.

**Bujar Bajra:** kërkoi se pas këtij takimi është mirë të mbahet edhe një takim me kryqin e kuq dhe të koordinohemi për ditët në vijim.

## **2.Të ndryshme**

Shtabi vendosi që më datë 15.04.2020 te mbahet mbledhja e radhës dhe të mirren vendime konkrete.

**Procesmbajtësja: Ilirjana Berisha**



## **Procesverbal i mbledhjes së Shtabit Komunal për Parandalimin e COVID 19, i datës 15.04.2020**

### **Të pranishëm:**

- 1.Besim Ilazi, Kryetar i Komunës, Kryesues i Shtabit
- 2.Diana Bajrami Reka- - Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- 3.Bujar Bajra Zyrtar për Alarmit dhe Koordinimin Enerjetic
- 4.Fidaim Fazliu, Kryetar i Bashkësisë Islame në Kaçanik
5. Ramadush Osmani Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
6. Bahri Selimi, Drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
- 7.Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit Komunal në Kaçanik
- 8.Agim Mani, Asambleist
- 9.Sinan Zeneli, Drejtor i QKMF- në Kaçanik
- 10.Naim Hysa, përgjegjës i Kryqit të Kuq në Kaçanik
- 11.Kadri Krivanjeva, Asambleist
- 12.Besnik Salihu, Asambleist
- 13.Halim Shehu, Komandant i Stacionit Policor
14. Ylber Tusha, përfaqësues i biznesëve
- 15.Besnik Bajra, Inspektor Sanitar

### **REND DITE**

1. Diskutim rreth gjendjes aktuale lidhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut;
2. Të ndryshme

**1.Diskutim rreth gjendjes aktuale lidhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut**

#### **Kryetari i komunës z.Besim Ilazi:**

Mirë se keni ardhur në këtë takim të sotem. Nga takimi i dites së djeshme as sot nuk është se kemi shumë qartësi.

Megjithatë ne si shtab kemi drejtë të lëshojmë leje për personat që të qarkullojnë vetem brenda komunës.

#### **Raporti i Drejtorit të QKMF- Kaçanik, z. Sinan Zeneli:**

## Procesverbal i mbledhjes së Shtabit Komunal për Parandalimin e COVID 19, i datës 21.04.2020

### Të pranishëm:

- 1.Besim Ilazi, Kryetar i Komunës, Kryesues i Shtabit
- 2.Diana Bajrami Reka- - Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- 3.Bujar Bajra Zyrtar për Alarmit dhe Koordinimin Energjent
- 4.Fidaim Fazliu, Kryetar i Bashkësisë Islame në Kaçanik
5. Ramadush Osmani Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
6. Bahri Selimi, Drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
- 7.Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit Komunal në Kaçanik
- 8.Agim Mani, Asambleist
- 9.Sinan Zeneli, Drejtor i QKMF- në Kaçanik
- 10.Naim Hysa, përgjegjës i Kryqit të Kuq në Kaçanik
- 11.Kadri Krivanjeva, Asambleist
- 12.Besnik Salihu, Asambleist
- 13.Halim Shehu, Komandant i Stacionit Policor
14. Ylber Tusha, përfaqësues i biznesëve
- 15.Besnik Bajra, Inspektor Sanitar
16. Doktoresha Sevdije Mehmeti nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë

### REND DITE

1. Diskutim rreth gjendjes aktuale lidhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut;

## **Procesverbal i mbledhjes së Shtabit Komunal për Parandalimin e COVID 19, i datës 26.04.2020**

### **Të pranishëm:**

- 1.Besim Ilazi, Kryetar i Komunës, Kryesues i Shtabit
- 2.Diana Bajrami Reka- Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- 3.Bujar Bajra Zyrtar për Alarmit dhe Koordinimin Emergjent
- 4.Fidaim Fazliu, Kryetar i Bashkësisë Islame në Kaçanik
5. Ramadush Osmani Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
- 6.Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit Komunal në Kaçanik
- 7.Agim Mani, Asambleist
- 8.Sinan Zeneli, Drejtor i QKMF- në Kaçanik
- 9.Naim Hysa, përgjegjës i Kryqit të Kuq në Kaçanik
- 10.Kadri Krivanjeva, Asambleist
- 11.Besnik Salihu, Asambleist
- 12.Halim Shehu, Komandant i Stacionit Policor
13. Ylber Tusha, përfaqësues i biznesëve
- 14.Besnik Bajra, Inspektor Sanitar
15. Lul Raka, Mikrobiolog

### **REND DITE**

#### **1. Diskutim rreth gjendjes aktuale lidhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut;**

**Kryetari i komunës z.Besim Ilazi:**

Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit në takimin e sotëm. Përshëndes në veçanti profesorin Lul Raka.

Më lejoni t'ju informojë që mbrëm kemi pranuar rezultatet nga Instituti i Shëndetësisë të cilat fatkeqisht kanë rezultuar pozitive dhe rastet janë një në fshatin Rekë dhe një në fshatin Runjevë.

Njëri nga të infektuarit ka pasur kontakte edhe me mjek në QKMF prandaj 13 punëtor janë vetëizoluar, rastet janë si pasojë e kontakteve.

Ne nuk duhet të hezitojmë të kërkojmë testimin, duhet ti identifikojmë të gjithë ata që kanë pasur kontakte dhe ta shkëpusim këtë zingjir.

Propozojë që të gjitha këto lagje të vetëizolohen dhe rastet që kanë më shumë mundësi të përhapjes më të madhe duhet të testohen.

**Kryetari:**

Me përjashtim të këtyre masave ne po presim edhe rekomandime nga Ministria.

Është mirë që të izolohet Runjeva, lagjia Qorrash dhe lagjia Dedaj në Doganaj si pasojë e kontaktit me të prekurit.

Kërkojë nga policia që të ketë më shumë patrullime.

**Diana Bajrami Reka- Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:**

Ne duhet të shikojmë edhe se si do të veprohet edhe në furnizimin me ushqim sepse nuk kemi edhe shumë rezerva ushqimore për të gjithë.

**Inspektori Komunal Besnik Bajra:**

Të gjithë personave që kanë pasur kontakt duhet ti dergohet vendim për ndalim të qarkullimit.

**Drejtori i Shërbimëve Publike dhe Emergjente Ramadush Osmani:**

Masa e karantinimit të këtyre lagjëve është masa e parë, ne e kemi diskutuar me kryetarin për hapjen e qendrës operative për ti pas të gjitha informatat.

Evidencia është numër një pastaj të tjerat.

**Kryetari:**

Njoftoj shtabin se bisedoi me Ministrin e Shëndetësisë dhe se sipas tij ka rekomandim që më mirë të izolohet lagjia dhe personat të cilët shkojnë për të blerë në markët të porosisinë nga jashtë.

**Anëtarët e shtabit** kerkuan nga Inspektori Komunal të merr vendim për ndalim të qarkullimit të familjarëve të afërm të personave të prekur pra të vetëizolohen dhe në të dy vendbanimet të ketë patrolla të policies, ky vendim jetë deri në vendim tjetër.

Qendra Informativë u vendos të caktohet neser nga Drejtoria e Shërbimëve Publike dhe Emergjente si dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale.

**Kryetari i Bashkësisë Islame z.Fidaim Fazliu:**

Kerkoi që informimi të del nga shtabi qoftë me video të shkurtra apo me pastime. Ndoshta me video është më mire, sipas tijë për faktin se personat të cilët nuk mund të lexojnë e kanë më lehtë ta kuptojmë.

Procesmbajtësja: Ilirjana Berisha





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipality of Kacanik

### Procesverbal i mbledhjes së Shtabit Komunal për Parandalimin e COVID 19, i datës 28.04.2020

#### Të pranishëm:

- 1.Besim Ilazi, Kryetar i Komunës, Kryesues i Shtabit
- 2.Diana Bajrami Reka- Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- 3.Bujar Bajra Zyrtar për Alarmit dhe Koordinimin Emergjent
- 4.Fidaim Fazliu, Kryetar i Bashkësisë Islame në Kaçanik
5. Ramadush Osmani Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
- 6.Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit Komunal në Kaçanik
- 7.Agim Mani, Asambleist
- 8.Sinan Zeneli, Drejtor i QKMF- në Kaçanik
- 9.Naim Hysa, përgjegjës i Kryqit të Kuq në Kaçanik
- 10.Kadri Krivanjeva, Asambleist
- 11.Besnik Salihu, Asambleist
- 12.Halim Shehu, Komandant i Stacionit Policor
13. Ylber Tusha, përfaqësues i biznesëve
- 14.Besnik Bajra, Inspektor Sanitar
- 15.Drejtori Rajonal i Policisë
16. Doktoresha Sevdije Mehmeti nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë

## REND DITE

### 1. Diskutim rreth gjendjes aktuale lidhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut;

**Kryetari i komunës z. Besim Ilazi:**

Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit në takimin e sotëm dhe ju falenderoj të gjithë juve për kontributin tuaj të vazhdueshem. Falenderoj doktoreshën Sevdije dhe drejtorin Emin që sot janë pjesë e këtij takimi.

Më lejoni t'ju informojë që mbrëm kemi pranuar rezultatet nga Institut i Shëndetësisë të cilat fatkeqsisht një rast ka rezultuar pozitive në fshatin Runjevë, ndërsa në fshatin Rekë 6 raste kontakti me familjaren e infektuar kanë rezultuar fatmirësisht negative dhe 6 raste të tjera po ashtu tek familja Deda në fshatin Doganaj kanë rezultuar negative.

Gjithësej numri i të prekurëve ka shkuar në 7 dhe se për ne është mjaftë shqetësuese.

Me munësit e Institutit ne duhet ti testojmë edhe personat që kanë pasur kontakte më të prekurit.

Në rastin e familjes Qorri bashkëshorti i të prekurës ka refuzuar që të bëjë testimin, ndërsa sot po në këtë familje do të bëhen edhe 3 ritetime në këtë familje ndërsa nga familja Berisha do të testohen 10 persona që kanë pasur kontakt me të prekurin nga Runjeva por që jetojnë në qytet.

Tani më kemi shqiptuar edhe gjoba mandatare dhe besoj se kjo do të shërbet si mësim tek qytetarët.

**Doktoresha Sevdije Mehmeti nga Institut Kombëtar i Shëndetësisë:**

Me vjen keq që ka tashmë raste positive në komunën tuaj por e mira e kësaj fatkeqësise është që tek familja Qorri kanë rezultuar negative.

Shpresojë që tek familja Qorri të pranoj bashkshorit i të prekurës të bëjë testimin ndërsa me sjelljet e familjes Berisha jemi të kënaqr.

Është mirë që të mbahen nën vëzhgim dhe personat të rrijnë në vetë izolim sepse po lëvizën do të përhapen rastet edhe më shumë, do të ketë ndoshta pakënaqësi por me rëndësi është që të kemi rezultate pozitive.

**Drejtori Rajonal i Policisë Emin Beqiri:**

Falemnderit Kryetar përshëndetje për të gjithë. Në takimin e parë nuk keni pas asnjë rast pozitiv, por Kaçaniku nuk mund të jetë imun dhe tanimë kemi edhe raste pozitive.

Sa i përketë çështjes së sigurisë ne në Ferizaj kemi qenë mjaftë strikt dhe kjo duhet të mirëmbahet edhe në Kaçanik.

Nuk do të thotë që është e domosdoshme të shpallet Runjeva në Karantinë por vetëm si vatër e virusit. Sepse nëse shpallet në Karantinë do të jetë më e vështirë të përballet gjendja dhe të menaxhohet si duhet sepse kërkesat janë të ndryshme.

Sa i përket atyre që nuk pranojnë ta bëjnë testin duhet tu bëhet me dije se nëse nuk pranojnë do të kenë patrollë të plicisë gjatë gjithë kohës para shtëpisë së tyre.

#### **Komandanti i Policisë, Kapiten Halim Shehu:**

Falemnderit për pjesëmarrje. Këto ditë jemi duke u angazhuar edhe në profesione tjera sepse po përballemi me çdo gjë.

Lidhur me karantinimin e këtyre lokalitetëve dje kam marr shkresë nga Naser Ramadani që të vetë izolohen këta familje.

Sot nga familja Berisha kemi pas telefonat se kanë nevojë për barna dhe shërbim mjekësor, ndërsa për gjëra ushqimore nuk kanë cekë diçka.

Kemi vazhdimisht patrolla në pikat e caktuara.

#### **Kryesuesi i Kuvendit Komunal z.Kemal Murseli:**

Mirë që janë testuar këto familje dhe që mbrëm patëm vetëm një të infektuar.

Është mirë që të dihet burimi i infeksionit tek zonja e infektuar me virus, ta dijmë se nga e ka marrë nga spitali ku ka qenë apo tjera ka, sepse nëse e ka marr në spital ne nuk kemi nevojë ti mbajmë në karantinë pasi që edhe familjarët kanë rezultuar negative.

Mirë që edhe tek familja Deda kanë dal negative rezultatet.

Ne nuk duhet të bijm pre e presionëve të personave që nuk pranojnë të vetë izolohen.

Tek administratorët e fshatrave duhet t'ia bëjmë me dije se në këtë mënyrë nuk mbrohet qytetari në atë mënyrë po mbrohet duke u izolu.

Aspekti psikologjik është diçka tjeter dhe trajtimi psikologjik është i rëndësishëm dhe ne si Kaçanik kemi nevojë për përkrahje nga Ferizaj në këtë aspekt.

#### **Inspektori Komunal Besnik Bajra:**

I kam përgatitur të gjitha vendimet për të gjithë personat e kërkuar për vetë izolim dhe është bërë disenfektimi i objekteve publike.

#### **Raporti i Drejtorit të QKMF- Kaçanik, z. Sinan Zeneli:**

Përvendetje për të gjithë.

Sa i përketë vizitave ne i kemi vizituar familjet dhe jemi duke kryer shërbime edhe sot një ekip mjekësore do të shkojë në vizitë.

Edhe pse nuk është në kompetencë tonë por ne kemi kerkuar nga KEDS dhe Kabllovik që ti lirojnë nga shpenzimet për këtë muaj këto familje.

Ne jemi të gatshëm të përballemi me çdo sfitë dhe nuk kemi ndërmend të ndalemi.

**1.Kryetari i Komunës:** u ka prezantuar projektin e Partners Kosova para anëtarëve të shtabit dhe njëkohësisht u është shpërndar edhe përshkrimi i projektit në kopjë për të gjithë anëtarët e njëjtë do tu shpërndahet edhe anëtareve të KKSB-së në e-mail për faktin se KKSB nuk është duke mbajtë takime shkaku i pandemisë.

Deri sa nuk ka rezultate të tjera u kërkua që patrollat e policisë të qëndrojnë në pikë të caktuara.

Procesmbajtësja: Ilirjana Berisha



**Procesverbal i mbledhjes së Shtabit Komunal për Parandalimin e COVID 19, i datës 04.05.2020**

**Të pranishëm:**

- 1.Besim Ilazi, Kryesues i Shtabit
- 2.Diana Bajrami Reka- Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- 3.Bujar Bajra Zyrtar për Alarmit dhe Koordinimin Emergjent
- 4.Fidaim Fazliu, Kryetar i Bashkësisë Islame në Kaçanik
5. Ramadush Osmani Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
- 6.Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit Komunal në Kaçanik
- 7.Agim Mani, Asambleist
- 8.Sinan Zeneli, Drejtor i QKMF- në Kaçanik
- 9.Naim Hysa, përgjegjës i Kryqit të Kuq në Kaçanik
- 10.Kadri Krivanjeva, Asambleist
- 11.Besnik Salihu, Asambleist
- 12.Halim Shehu, Komandant i Stacionit Policor
13. Ylber Tusha, përfaqësues i biznesëve
- 14.Ylber Bajra, Nënkyetar i Komunës
- 15.Drejtori Rajonal i Policisë Emin Beqiri
16. Doktoresha Sevdije Mehmeti nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë
- 17.Bajram Gecaj Zëvendësminister i Ministrisë së Punëve të Brendshme
18. FATBARDHA EMINI-HALABAKU, Zëvendësministre në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal

**REND DITE**

1. Diskutim rrëth gjendjes aktuale lidhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut;

**Nënkyetari i komunës z.Ylber Bajra:**

Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit në takimin e sotëm dhe ju falenderoj të gjithë juve për kontributin tuaj të vazhdueshem në veçanti të gjithë vullnetarët për punën e tyre.

Pajtohem me këkresën e Komandantin për lirim të pjesës tjetër të banorëve.

Është mirë që personat e izoluar ti respektojne masat dhe të vëzhgojen kohë pas kohe.

## Z. Bajram Gecaj Zëvendësministër i Punëve të Brendshme:

Përvetësuesi i Këshillit të Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë po dalin Anti-Kushtetuese sa i përketë Lirisë së Lëvizjes.

Së bashku me zv. Ministrën e Pushtetit Lokal kemi vizituari deri më tanë 10 komuna dhe kemi parë që është duke u menaxhuar situata mjaftë mirë.

Në veçanti ne duhet të falenderojmë punëtorët mjekësor për punen e tyre.

Si duket jemi shteti i katërt në Evropë për numër më të vogël të vdekjes.

Dëgjova këtu se paska pasur persona që kanë lëvizur por është mirë të mbahen në vetëizolim. Kërkojë që të mos relaksohami që kaloj pandemia duket të vazhdojmë me respektimin e masave sepse ka mundësi që mund të kthehet prap.

Në Kenia e kemi pa që as temperatura nuk ka mund ta ndal virusin.

Ne duhet të punojmë me nivelin qëndror dhe duhet të marrin ndihma komunat sepse deri më tanë nuk e kemi pa që kanë marr ndihma.

Kisha këruar nga ju që të na tregoni kërkesat apo shqetësimit tuaja dhe pastaj ne ti përcjellim në nivel qëndror.

## FATBARDHA EMINI-HALABAKU, Zëvendësministre në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal:

Komuna e Kaçanikut ka ballafaquar deri von virusin edhe pse ka pasur komuna fqijne që janë prekur nga virusi që në fillim siç është Komuna e Vitisë.

E dim se si pasojë e kësaj pandemie do të ketë problem në rimëkëmbjen e bizenesëve dhe barra kryesore do të jetë e komunave.

Ju përgëzoj kryetar sepse është meritë e kryetarve të komunave, policisë dhe stafit mjekësor.

Ne do të bëjmë përpjekje për tju ndihmuar sepse e dijmë që gjendja ekonomike veç se është duke u rënduar.

## Kryetari u Komunës:

Përveç anëtarëve të shtabit pjesë e jona vazhdimisht kanë qenë edhe Doktor Luli, Doktoresha Sevdije dhe Drejtori Rajonal i Policisë të cilët i falenderoj për angazhimin e tyre.

## Kryesuesi i Kuvendit Komunal z.Kemal Murseli:

Siq u theksua edhe nga kryetari gjendja në komunën tonë nuk është edhe e mirë në aspektin ekonomik sepse nevojat e qytetarëve janë tejet të mëdha dhe po ashtu ata kanë edhe shqetësimë sepse shpesh herë vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë po dalin Anti-Kushtetuese sa i përketë Lirisë së Lëvizjes.

Unë kam dhënë edhe mendimin timë që Runjeva të futet në karantimin sepse ka qenë shqetësimi i imi sidomos pas marrjes se 4 mostrave të cilat rezultuan pozitiv.

Pajtohem me komandantin tashmë pas rasteve tjera negative që të lirohet lagjja dhe karantinimi të vazhdojë vetëm afér shtëpisë.

#### 1. Kryetari i Komunës:

Pajtohem me këtë që ata familje të qëndrojnë në vetizolin dhe të mos merrem masa më të ashpëra.

Ne e kemi lagjen në izolin dhe të gjithë kanë rezultuar negative pra është masë e ashpër dhe ne duhet t'ju kërkojmë atyre vetëm ti respektojnë masat.

Por sa i përketë gjendjes ekonomike të familjëve në nevojë tash do të na njoftojë edhe Kryqi i Kuq.

Nëse është e nevojme nëpërmjet kryesuesit ne mund të thrrasim kuvendin edhe të ndajm edhe një shuëm të mjetëve.

#### Naim Hysa, Kryqi Kuq:

Deri më tanë janë shpërndar mbi 2 mijë pako.

Tash situata është rënduar dhe ne kemi shumë kërkesa edhe nga familjet që ju kemi dërguar pako në fillim.

Po ashtu kemi edhe familje të cilët kanë punuar në sektorin privat dhe tashmë nuk kanë të ardhura më.

Mendoj se për momentin duhet ti ndihmojmë diku rrëth 500 familje.

#### Kemajl Murseli Kryesues i Kuvendit:

Propozit që Kryqi i Kuq të bëjë një plan për javën e ardhshme dhe pastaj të na njoftojë saktë se sa familje kanë nevojë për ndihma dhe se si do të shpërndahen ato.

Procesmbajtësja: Mirjana Berisha



## Procesverbal i mbledhjes së Shtabit Komunal për Parandalimin e COVID 19, i datës 12.05.2020

### Të pranishëm:

- 1.Besim Ilazi, Kryesues i Shtabit
- 2.Diana Bajrami Reka- Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- 3.Bujar Bajra Zyrtar për Alarmit dhe Koordinimin Emergjent
- 4.Fidaim Fazliu, Kryetar i Bashkësisë Islame në Kaçanik
5. Ramadush Osmani Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
- 6.Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit Komunal në Kaçanik
- 7.Agim Mani, Asambleist
- 8.Sinan Zeneli, Drejtor i QKMF- në Kaçanik
- 9.Naim Hysa, përgjegjës i Kryqit të Kuq në Kaçanik
- 10.Kadri Krivanjeva, Asambleist
- 11.Besnik Salihu, Asambleist
- 12.Halim Shehu, Komandant i Stacionit Policor
13. Ylber Tusha, përfaqësues i biznesëve

### REND DITE

1. Diskutim rrith gjendjes aktuale lindhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut;

Kryetari i Komunës z.Besim Ilazi:

Përshëndetje për të gjithë, mirë se keni ardh në takimi e radhës, që tashmë janë takime të rregullta javore.

Jeni edhe pjesë e grupit në viber dhe aty po informohemi për situatën aktuale dhe siç e dini deri më tanë kemi vetëm 3 persona të prekur nga virusi në komunën tonë.

Është mirë që të vazhdohet me respektimin e masave dhe të mos na ndodh si në komunat tjera që ka pasur raste të reja të si rezultat i kontaktëve, ndërsa tek ne nga 7 të prekur me virus numri ka rënë në 3 dhe shpresoj të mos kemi raste të reja.

Nuk jam shumë i informuar nëse ka filluar të shpërndahet pako emergjente e qeverisë po mbasë përfaqësuesi i Biznesëve këtu mund të na informojë, por fillimisht ja kaloj fjalën Komandantit të Policisë.

Jemi duke i përkrahur familjet të cilët po kërkojnë ndihmë, dje kemi ndihmuar edhe familjen Berisha.

Tash kemi më shumë kërkesa individuale, por jemi duke shikuar tash ti prekim rastet më të ndjeshme.

Kam kërkuar nga administratorët që të bëjnë lista të familjëve më me nevojë dhe pastaj të shohim me pranimin e kontigjentit të 500 pakoëve.

**Kryetari i Bashkësisë Islame z.Fidaim Fazliu:**

Përvendetje për të gjithë, fillimisht ju falenderojë për angazhimin tuaj të vazhdueshëm.

Është për tu përgëzuar puna e komunës sa i përketë informimit të saktë dhe të shpejtë.

Brenda dy javë ne kemi shpërndar 756 pako dhe totalin nëse e marrrim i prek diku 900 familje të cilat i kemi vizituar nga muaji mars.

Po shpresoj që edhe këto tri raste të janë negative.

**Kryetari i Komunës:**

Pajtohem plotësisht me me ju kryetar sepse me të vërtet ne kemi qenë unik dhe shumë bashkëpunues si shtab.

Është shumë mirë që edhe tek qytetarët nuk ka pasur ankesa sa i përket punës sonë.

Po besoj se do të vazhdojmë kështu edhe më tejë.

**Asambleisti Besnik Salihu:**

Është mirë që të bëhet lehtësim të masave edhe tek bizneset tjera dhe jo vetëm të ndërtimtarisë sepse do të ketë në të ardhmen një kollaps ekonomik dhe kjo do të jetë shumë negative dhe shqetësuese për ne.

Shpresoj të ketë më shumë lehtësira sepse sektoret që i permendi kryesuesi nuk mund të mbijetojnë por edhe shumë biznese tjera.

Shpresojë që qeveria ta ngrisë këtë çështje sepse së dihet nuk ka edhe teste të mjafueshme dhe ne si shtet duhet të mobilizohemi sepse së ka thën edhe doktor Luli virusi mund të kthehet edhe në shtator.

**Drejtori i QKMF:**

Ky nuk është një lloj gripi por një virus më i rrezikshëm dhe lehtë i përhapur prandaj nuk duhet ta neglizhojmë dhe duhet të vazhdojmë ti respektojmë masat.

Ne duhet ta kemi edhe vedjen në respektimin e masave kemi klinika të mylluar si komplet pediatria vetëm në Angli për këtë periudh janë 35 mijë vdekje.

Procesverbal i mbledhjes së Shtabit Komunal për Parandalimin e COVID 19, i datës 22.05.2020

**Të pranishëm:**

- 1.Besim Ilazi, Kryesues i Shtabit
- 2.Diana Bajrami Reka- Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- 3.Bujar Bajra Zyrtar për Alarmit dhe Koordinimin Emergjent
- 4.Fidaim Fazliu, Kryetar i Bashkësisë Islame në Kaçanik
5. Ramadush Osmani Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
- 6.Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit Komunal në Kaçanik
- 7.Agim Mani, Asambleist
- 8.Sinan Zeneli, Drejtor i QKMF- në Kaçanik
- 9.Naim Hysa, përgjegjës i Kryqit të Kuq në Kaçanik
- 10.Kadri Krivanjeva, Asambleist
- 11.Besnik Salihu, Asambleist
- 12.Halim Shehu, Komandant i Stacionit Policor
13. Ylber Tusha, përfaqësues i biznesëve

**REND DITE**

1. Diskutim rreth gjendjes aktuale lidhur me pandemin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut;

**Kryetari i Komunës z.Besim Ilazi:**

Përshëndetje për të gjithë, mirë se keni ardh në takimi e radhës, fillimisht ju falenderoj për angazhimin tuaj në menaxhimin e kësaj situate.

Tani më nuk kemi shumë kërkesa ka rënë numri kemi kërkesa vetëm nga individë.

Për shkak të festës së Bajramit shpresojmë ti shpërndajmë sot të gjitha pakot.

Karrocën të cilën e kam kërkuar pér një të moshuar nga fshati **Kotlinë**, falenderoj komandantin pér sigurimin e karroces.

Në fshatin Kotlinë i kemi 10 familje me të moshuar pa mbikqyrje të cilat i kemi furnizuar me ushqim.

**Kryetari i Bashkësisë Islame z.Fidaim Fazliu:**

Pershendetje pér të gjithë.

Po lidhem fillimisht të familja në Bajnicë, nuk është anashkaluar nga askush është familja më e përkdhelur dhe më e përkrahur në fshatin tote, ne kemi dërguar vazhdimesh ndihma atje dhe po ashtu në aspektin shëndetësor i kemi ndihmuar asaj familje pér shkak se nga ajo familje janë dy persona me aftësi të kufizuara.

Kemi kërkesa të vazhdueshme pér hapjen e xhamive, por edhe pér Bajram nuk do të ketë falje të namazit dhe kjo pér shkak të rujtes së shëndetit të masës.

Urojë që të dalim nga kjo situatë sa më mirë dhe të vazhdojmë me respektimin e masave, gjithashtu ju falenderojë të gjithve pér angazhim tuaj të vazhdueshëm.


**Kryetari i Komunës:**

Falemnderit të gjithëve pér raportimet dhe punën tuaj të vazhdueshme, ju falenderoj edhe pér komunikimin dhe bashkëpunimin tuaj.

Për fund më duhet t'ju njoftojë që kam bërë një propozim-vendim pér lirim nga qiraja pér pronën komunale pér vitin 2020 dhe pér lirim nga pagesa pér shërbime shëndetësore deri në përfundim të pandemisë. Ky propozim vendim ka kaluar në Komitetin pér Politikë dhe Financa dhe shpresojë që edhe në mbledhjen e kuvendit komunal të kalojë propozim vendimi dhe ti ndihmojmë qytetarët tanë.

Mirembetëshi!

Procesmbajtësja: **Ilirjana Berisha**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

01Nr.400/01-8928/20  
Kaçanik, 26.03.2020

Bazuar ne Vendimet e Qeverisë të Republikës së Kosovës për menaxhimin e situatës emergjente të krijuar nga Pandemia COVID-19, Kërkesës së Shtabit Emergjent Komunal për parandalimin e Pandemisë COVID 19, neneve 12.2(d) lidhur me nenin 40.2 (b) dhe (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershori 2008) të Ligjit Nr.07/L-001 mbi ndarjet buxhetore të vitit 2020, të nenit 34.5 lidhur me nenin 6.2 dhe 61 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr.400/01-8928/20 prej datës 25.03.2020, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 26 Mars 2020 mori këtë:

## VENDIM

### Për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës emergjente të krijuar nga Pandemia COVID-19

1. Duke pasur për bazë situatën emergjente dhe gjendjen ekonomike të banoreve të Komunës së Kaçanikut, lejohen mjete financiare nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve në shumën prej 100,000.00 € (Njëqindmijë euro). Shuma e mjeteve financiare për këtë qëllim do te sigurohet nga Nën programet ne vijim: Nën programi 16028 shuma 20,000.00 € (njëzetmijë euro) Nën programi 16328 shuma 30,000.00 €(tridhjetëmijë euro) dhe Nën programi 18028 shuma prej 50,000.00 € (pesëdhjetëmijë euro). Duke pasur për bazë situatën emergjente dhe gjendjen ekonomike të banoreve të Komunës së Kaçanikut
2. Shuma e mjeteve buxhetore të lejuara si në pikën 1. të këtij vendimi do të shfrytëzohet për sigurimin e artikujve (pakove) ushqimore, higjenikë për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, dezinfektimin e hapësirave publike, furnizimin me mjete mbrojtëse nga COVID 19, dhe mbulimin e nevoja tjera qe dalin si rezultat i parandalimit te kësaj sëmundjeje.
3. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, e cila drejtori të njëtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Mërseli



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik



01-104/02-8842/20

Kaçanik, 16.03.2020

DATË/A:	16.03.2020
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës z.Albin Kurti Ministrinë e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës z.Arben Vitia Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit z. Lumir Abdixhiku
CC:	Shtabi Komunal për Parandalimin e COVID-19 në Komunën e Kaçanikut
NGA/OD/FROM:	Z. Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për ndihmë

Të nderuar,

Situata e krijuar nga koronavirusi i ri është padyshim një sfidë në të cilën ndodhemi i tërë shteti.

Padiskutim që në këto ditë çdokush nga ne ndjen shqetësim për gjendjen e krijuar dhe rrezikun që mund të na kanoset si shoqëri.

Duke i pas parasysh rrethanat e krijuara, Komuna e Kaçanikut me daten 13.03.2020 ka marrë Vendim Nr. 01 104/02-8765 Për Formimin e Shtabit Për Parandalimin E COVID-19.

Komuna e Kacanikut nuk ka kapacitete të mjaftueshme për t'iu dalur në ndihmë të gjithë familjeve në nevojë, e që në komunën tonë janë mbi 800 (tetëqind) familje me asistencë sociale.

Po ashtu, nuk kemi paisje të mjaftueshme dhe të nevojshme për parandalimin e këtij virusi, si: doreza, maska, mjejte dezinfektuese etj. Gjithashtu kemi analizuar se në komunën tonë ka mungesë të gjëra e esenciale-ushqimore e në veçanti të miellit.

Andaj, duke e analizuar situatën e krijuar, kërkojmë nga ju që të jemi në koordinim të plotë dhe që të na ndihmoni që së bashku ta tejkalojmë edhe këtë sfide.

Me respekt



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik



01-104/02 - 92 09 / 20

Kaçanik, 27.04.2020

DATE/A:	27.04.2020
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Ministrinë e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës z.Arben Vitia
CC:	Shtabi Komunal për Parandalimin e COVID-19 në Komunën e Kaçanikut
NGA/OD/FROM:	Z. Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për ndihmë

Inderuar Ministër, z.Arben Vitia,

Situata e krijuar nga koronavirusi është padyshim një sfidë në të cilën ndodhemi i tërë shteti.

Padiskutim që në këto ditë çdokush nga ne ndjen shqetësim për gjendjen e krijuar dhe rezikun që mund të na kanoset si shoqëri me përhapjen e virusit.

Duke e pas parasysh që edhe në Komunën e Kaçanikut më datë 25.04.2020 kemi të konfirmuar dy raste pozitive, si raste të para në komunën tonë dhe dje më datë 26.04.2020 patëm edhe 4 raste të tjera me COVID-19 situata veç se po vjen dhe rëndohet ditë e më shumë.

Komuna e Kacanikut nuk ka kapacitete të mjaftueshme për t'u dalur në ndihmë të gjithë familjeve në nevojë e që në komunën tonë janë mbi 800 (tetëqind) familje me asistencë sociale.

Gjithashtu tani më pas rastëve pozitive, të konfirmuara ne jemi të obliguar që ti ndihmojmë edhe familjet e personave të prekur me virus por edhe të atyre familjeve që kanë pasur kontakte të afërtë me të prekurt.

Andaj, duke e analizuar situatën e krijuar, kërkojmë nga ju që të jemi në koordinim të plotë dhe që të na ndihmoni që së bashku ta tejkalojmë edhe këtë sfide.

Me respekt



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
**Komuna e Kaçanikut**  
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik



Kaçanik, 27.04.2020

DATË/A:	27.04.2020
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Shoqata Bamirëse "Jetimat e Ballkanit"
CC:	Shtabi Komunal për Parandalimin e COVID-19 në Komunën e Kaçanikut
NGA/OD/FROM:	Z. Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për ndihmë

Të nderuar,

Fillimisht u jemi shumë mirënjojës për kontributin tuaj në lehtësimin e gjendjes ekonomike të familjëve në nevojë të Komunës së Kaçanikut, e sidormos në këtë kohë pandemie.

Padiskutim që një situatë si kjo është mjaftë shqetësuese për në si institucion.

Duke e pas parasysh që edhe në Komunën e Kaçanikut më datë 25.04.2020 kemi të konfirmuar dy raste pozitive, si raste të para në komunën tonë dhe dje më datë 26.04.2020 patëm edhe 4 raste të tjera me COVID-19 situata veç se po vjen dhe rëndohet ditë e më shumë.

Komuna e Kacanikut nuk ka kapacitete të mjaftueshme për t'i dalur në ndihmë të gjithë familjeve në nevojë e që në komunën tonë janë mbi 800 (tetëqind) familje me asistencë sociale.

Gjithashtu tani më pas rastëve pozitive, të konfirmuara ne jemi të obliguar që ti ndihmojmë edhe familjet e personave të prekur me virus por edhe të atyre familjeve që kanë pasur kontakte të afërtë me të prekurtit.

Andaj, duke e analizuar situatën e krijuar, kërkojmë nga ju që sipas mundësive tuaja të në ndihmoni me pako ushqimore për familjet në nevojë.

Ju falenderojmë paraprakisht për bashkëpunimin tuaj.

Me respekt



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kacanik**  
**Municipal Kacanik**

01 Nr. 60/01-9754/20  
 Kaçanik, 27.05.2020

Në bazë të nenit 12.2 (c) lidhur me nenin 40.2(g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4 Qershori 2008), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 60/01-9754/20 prej datës 15.05.2020, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 27 Maj 2020, mori këtë:

### **VENDIM**

#### **PËR LIRIM NGA QIRAJA KOMUNALE PËR SHFRYTËZUESIT E PRONËS KOMUNALE PËR VITIN 2020 SI DHE LIRIM NGA PAGESA E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE DERI NË PËRFUNDIM TË PANDEMISË COVID -19**

1. Me këtë Vendim, Lirohen nga qiraja komunale shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2020, më konkretisht pika 9.4, 9.4.1, 9.5, 9.5.1 dhe 9.6 e Rregullores Nr. 01/2016 Për Pagesën e Tarifave, Ngarkesave Administrative, Gjobave dhe Shërbimeve të tjera Komunale.
2. Lirohen nga pagesa e shërbimeve shëndetësore të gjithë qytetarët e komunës së Kaçanikut deri në përfundim të pandemisë COVID-19 më konkretisht pika 27.1, 27.2 dhe 27.3 e Rregullores NR. 01/2016- Për Pagesën e Tarifave, Ngarkesave Administrative, Gjobave dhe Shërbimeve të tjera Komunale.
3. Lirimet nga pika 1 dhe 2 e këtij Vendimi bëhen në bazë të arsyetimeve të Kryetarit të Komunës- për shkak të gjendjes së krijuar si rezultat i pandemisë Covid 02019.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

**Me këtë vendim njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
 Kemal Mërselj



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

### Shpenzimet për Covid -19 për Komune e Kaçanikut

Blloku kodues	Përshtkim	Në proces për shpenzim	Shpenzimet
652 - KAÇANIK		12,383.71	72,179.00
00099 - PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCËS NGA COVID-19	SHËRBIME KONTRAKTUESE TJERA	10,289.00	2,904.00
	FURNIZIME MJEKËSORE	500.00	12,061.00
	FURNIZIME PASTRIMI	980.00	0.00
	FURNIZIME ME USHQIM DHE PRJE	159.71	57,214.00
	PAISJE TJERA	455.00	0.00

Drejtori i DFEZH-së  
Bahri Selimi

